



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 931

Datë 21 / 4 / 2017

Në mbështetje të nenit 13, pika 1.14, nenit 23 parografi 1.2, nenit 65 paragrafit 4, Nenit 76 par.1 alineja 1.2 si dhe nenit 164, të Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina, dhe me propozimin e Këshillit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, duke u bazuar në nenin 9 të Rregullores së KD-së, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e datës, 02.03.2017 miraton:

**RREGULLORE
PËR INSTITUTIN E HULUMTIME SHKENCORE (IHSH)**

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

- Me këtë rregullore përcaktohen funksionimi themelor, puna kërkimore shkencore kriteret dhe transferi i diturive me qëllim të zhvillimit të punës së tërësishme shkencore, punës mësimore dhe profesionale në fushën shkencore të kinezilogjisë dhe disiplinave të përaferta shkencore, si dhe çështjet tjera të rëndësishme për studimet në Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në tekstin e mëtejmë FEFS.

Neni 2.

Qëllimi dhe veprimtaria

- Qëllimi i Institutit për Hulumtime Shkencore :**
- Funksioni themelor është puna kërkimore-shkencore
- Të avancojë infrastrukturën për punë kërkimore-shkencore me qëllim të ofrimit të shërbimeve në fushat e Edukimit Fizik dhe Sportit.
- Të avancojë hulumtimet në fushën e Metodikës së Edukatës fizike, Procesit stërvitor të Trajningut sportiv, Mjekësisë sportive, Rekreacionit, etj.

- 2.5. Të avancojë njohuritë mbi përgatitjen fizike të sportistëve kulmor të Kosovës, në mënyrë që të sigurojë bazë për arritjen e rezultateve në garat vendore e ndërkombëtare në Sport.
- 2.6. Të vlerësojë ndikimin e aktiviteteve fizike për pergaditjen e popullatës së përgjithshme me qëllim të zhvillimit te mirëqenies shëndetësore në Kosovë.
- 2.7. Të nxisë aktivitetet hulumtuese dhe të rrisë bashkëpunimin për punë hulumtues-shkencore të individëve dhe institucioneve brenda dhe jashtë Kosovës.
- 2.8. Të promovojë bashkëpunimin me sektorin publik dhe privat për zgjidhjen e problemeve kërkimore, në funksion të zhvillimit të infrastrukturës dhe realizimit të aktiviteteve fizike të popullatës në Kosovë.
- 2.9. Të krijojë infrastrukturën e mjartueshme, për hulumtime në fushën e sportit.
- 2.10. Të zhvillojë kapacitetet njerëzore në FEFS dhe më gjerë, për veprimtari shkencore kërkimore në fushën e Kinezilogjisë dhe shkencës.
- 2.11. Përcjell trendët botërore të kërkimeve shkencore, botime, konferanca, simpoziume “workshop”-e, etj.
- 2.12. Promovon edukimin fizik dhe shëndetësor, trajnimin dhe zhvillimin e shkathtësive në Praktikat menaxhuese të infrastrukturës sportive në Kosovë, mbi baza të kërkime shkencore

- 2.2. Për të realizuar qëllimet nga Neni 1, i kësaj Rregulloreje, Instituti për hulumtime Shkencore merret me veprimtaritë e më poshtme, por pa u kufizuar vetëm në këto:**
- 2.2.1. Do të realizojë hulumtime që lidhen me ruajtjen dhe zhvillimin shëndetit të popullatës (matjet e dimensioneve antropometrike, motorike dhe atyre funksionale), vlerësimin e ndikimit te aktivitetit fizik në statusin e sportistëve kulmor (matjet bio-medicinale antropologjike dhe sistemeve organike të trupit), përdorimi i të arriturave shkencore në botë dhe zbatimi i tyre në Sportin e Kosovës (publikimet periodike), me qëllim që trajnerët e Kosovës të zbatojnë njohuritë e përgjithshme teorike nga disiplinat e Kinezilogjisë dhe shkencave te Mjekësisë sportive.
 - 2.2.2. Do të realizojë dhe mbështes hulumtimet shkencore për vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve të ndryshme fizike e antropogjene në sistemet e organizmit të njeriut.
 - 2.2.3. Do të realizojë dhe promovojë studime interdisiplinare të cilat kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive fizike dhe performansave sportive, te sportistët e Kosovës.
 - 2.2.4. Do të ofrojë analiza (publikime periodike) dhe do të realizojë hulumtime në fushat e shkencës dhe Kinezilogjisë.
 - 2.2.5. Do të rekomandojë, aktivitetet për zhvillimin e resurseve njerëzore (edukimin dhe trajnimin e shkencëtarëve të rinj) në fushën e Kinezilogjisë dhe hulumtimeve shkencore.
 - 2.2.6. Do të ndërtojë bashkëpunim shkencor-profesional me institutet, institucionet, dhe organizatat apo individët brenda dhe jashtë vendit, përmes participimit në projekte që lidhem me hulumtime, (Asociacionet e Federatave të Sporteve vendore dhe ndërkombëtare dhe institucionet tjera relevante Kombëtare, etj.).
 - 2.2.7. Do të ofrojë shërbime për sektorin publik dhe privat, në lëmin e sportit.
 - 2.2.8. Do të organizojë dhe mbështes seminaret, konferencat, trajnimet, publikimet, forumet dhe format e tjera të organizimeve publike në lëmin e hulumtimeve shkencore.

- 2.2.9. Do të ndihmojë publikimin dhe blerjen e revistave, librave, e materialeve të tjera shkencore profesionale.
- 2.2.10. Do të përgatisë programe dhe materiale edukative për ngritjen e ndërgjegjes publike për edukim fizik, shëndetësor, sport dhe rekreacion.
- 2.2.11. Instituti do ta ketë adresën e vetë elektronike.
- 2.2.12. Do të i bart në web-faqe informacionet për të arriturat dhe veprimtarit e Institutit.
- 2.2.13. Në adresën e vetë elektronike “IHSH” pranon ide, përkrahje, mbështetje dhe sugjerime nga përkrahës dhe mbështetës të hulumtimeve shkencore.

Neni 3.
Organet e Institutit

3.1. Organet e Institutit janë:

- 2.1.1. Këshilli i Institutit.
- 2.1.2. Drejtori i Institutit.
- 2.1.3. Sekretari i Institutit.

Neni 4.
Këshilli i Institutit

4.1. Këshilli i Institutit përbëhet nga Drejtori, Sekretari, pesë anëtarë të rregullt dhe katër anëtar korrespondent:

- 4.1.1. Prodekan për çështje shkencore.
- 4.1.2. Prodekan për çështje mësimore.
- 4.1.3. Mentor i studimeve pasdiplomike-Master.
- 4.1.4. Një anëtar nga stafi akademik (profesorëve) të Këshillit të Fakultetit.
- 4.1.5. Një anëtar nga stafi akademik (asistentëve) të Këshillit të fakultetit.
- 4.1.6. Anëtarët e Këshillit të Institutit i zgjedhë Këshilli i Fakultetit, me mandat 4 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjeje.
- 4.1.7. Kryesues i Këshilli i Institutit, me mandat 4 vjeçar, është Drejtori i Institutit.
- 4.1.8. Kryesuesi, përkatësisht Drejtori i thërret dhe i udhëheqë mbledhjet e Këshillit të Institutit.
- 4.1.9. Vendimet e Këshillit të Institutit, merren me shumicë votash.
- 4.1.10 Sekretari i Institutit është anëtar i Këshillit të Institutit, me të drejtë vote.
- 4.1.11. 3(tre) + 1(një), anëtar Korrespondent, pa të drejtë vote (, Përgjegjësi i Departamentit të Sporteve, Përgjegjësi i Departamentit të Edukimit Fizik, Përgjegjësi i Departamentit të mjekësisë Sportive dhe Prorektori për Shkencë).

Neni 5.

- 5.1 Institutin e Hulumtimeve Shkencore e udhëheq, Drejtori i Institutit, i cili është përgjegjës për të gjithë aktivitetin hulumtues-shkencor dhe publikues.
- 5.2 Drejtori i Institutit zgjedhet nga Këshilli i Fakultetit, me mandat 4-vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

- 5.3 Drejtori i Institutit, zgjedhet nga radhët e anëtarëve të këshillit, nga stafi akademik (profesorëve) të Fakultetit të Shkencave Sportive.
- 5.4 Në punën e tij, Drejtori përkrahet nga Sekretari i Institutit, i cili propozohet nga Drejtori dhe aprovohet nga Këshilli i Institutit me mandat 4 vjeçar.
- 5.5 Sekretari duhet të jetë nga radhët e stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Sportive.
- 5.6 Institut bashkëpunon, mbanë takime dhe i harmonizon aktivitet me Departamentin e Sporteve, Departamentin e Edukimit Fizik dhe Departamentin e Mjekësisë Sportive në FEFS dhe me Institutet homologe në UP.
- 5.7 Drejtori dhe sekretari duhet të përkujdesen për informimin, aranzhimin e takimeve, konferencave dhe të kryejnë punët tjera të nevojshme, me përkushtim që sa më shumë të angazhojnë stafin akademik dhe të mbaj kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e Departamenteve përkatëse.
- 5.8 Sekretari përkujdeset për shënimet dokumentet dhe projektet e I. H. SH, si dhe arkivimin e tyre,(administratën).

Neni 6. Financimi

6.1. Aktivitetet e Institutit mundë të financohen nga burimet vijuese:

- 6.1.1. Nga fonde publike;
- 6.1.2. Nga projektet;
- 6.1.3. Nga aktiviteti vetanak;
- 6.1.4. Nga donacionet;
- 6.1.5. Nga burime të tjera, në përputhje me Ligjin dhe Statutin e UP-së.

Neni 7. Raportimi dhe llogaridhënia

- 7.1. Në fillim të çdo viti kalendarik, Drejtori i Institutit e prezanton raportin vjetor për vitin e mbaruar akademik dhe planin vjetor për vitin akademik vijues në lidhje me aktivitetet e Institutit të Hulumtimeve Shkencore, para Këshillit të Institutit.
- 7.2. Këshilli i Institutit, i aprovon ndaras me shumicë votash, Raportin vjetor dhe Programin vjetor.
- 7.3. Drejtori i Institutit, raporton para Këshillit të Fakultetit, Raportin e Aprovuar nga Këshilli i Institutit.
- 7.4. Drejtori i Institutit, ia dorëzon raportin vjetor dhe planin vjetor të miratuar, Dekanit të FEFS-it, për aprovim Rektoratit, (Prorektorit) për kërkime shkencore të UP-së.

Neni 8.
Kontraktimi i punëve

- 8.1 Pas arritjes së marrëveshjes për kontraktimin e punëve, Rektori, në bazë të të dhënave që merr nga Dekani i FEFS-it, për marrëveshjen e arritur për kontraktimin e punëve, nënshkruan kontratën, e cila duhet të përbajë:
- 8.1.1. Të gjitha elementet e marrëveshjes së arritur,
 - 8.1.2. Përcaktimin preciz të punëve dhe detyrave të punës,
 - 8.1.3. Vlerën precise të kontraktuar për secilin pozicion dhe punë,
 - 8.1.4. Vlerën e tërësishme të punës,
 - 8.1.5. Afati e kryerjes së punëve,
 - 8.1.6. Mënyrën e pagesës dhe afatin e ekzekutimit të pagesës.
- 8.2. Para, se të nënshkruhet kontrata nga Neni paraprak, Drejtori i Institutit, me pëlqimin e harmonizuar të Dekanit të FEFS-it dhe Këshillit të Institutit, e cakton bartësin e punës dhe kryesit e tjerë të punëve, duke marrë si kriter themelor mendimin e kontraktuesit të punëve, kompetencat profesionale e shkencore të kryesve të punës, si dhe mendimin e porositësit të punëve.
- 8.3. Në projektet dhe aktivitetet e veta, Institut mund të angazhojë edhe ekspertë jashtë UP-së, me propozimin e Drejtorit të Institutit, dhe Dekanit të FEFS-it dhe aprovimin e Këshillit të Institutit.

Neni 9.

Ndarja e mjeteve të realizuara dhe kompensimin për punën e kryer.

- 9.1. Pagesa e punëve të kryera bëhet sipas rregulloreve përkatëse të UP-së.
- 9.2. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara në bazë të punëve në specifikim do të bëhet në bazë të Raportit për kompensim, nga Drejtori i Institutit, duke e dëshmuar të Dekani, për sektorin e Financave të UP-së.
- 9.3. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara nga projektet apo shërbimet në bazë të punimeve të kryera bëhet sipas Rregullores “Për themelimin dhe parimet e funksionimit të instituteve në UP” nr. 2/513, Dt.25.10.2013, përkatësisht Neni 8 i Rregullores përkatëse të KD. Të UP-së.
- 9.4. Dekani i FSHS-së, verifikon, aprovon dhe nënshkruan Raportin e përpiluar nga Drejtori i Institutit mbi ndarjen e mjeteve të specifikuara, për secilin anëtar të Këshillit të Institutit, për secilin angazhim dhe ia dërgon shërbimit financier, i cili e përpilon aktvendimin lidhur me pagesën e punëkryesve, dhe e jep urdhëresën për pagesën e mjeteve të destinuara, vetëm me VENDIM, të nënshkruar nga Dekani.

Neni 10.

10.1. Kjo Rregullore hyn fuqi, në ditën e miratimit nga Këshilli i Drejtues i UP-së.


Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në procedurën e njëjtë si të miratimit.

Neni 11.

Për çfarëdo interpretimi apo kontesti, që nuk janë rregulluar shprehimisht me këtë Rregullore, vlejnë dispozitat tjera në fuqi, nga Statuti i UP-së, Ligjit Mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, apo Rregulloren përfunksionimin e Instituteve.

Dekani i FEFS

Prof. Asoc. Dr. Musa Selimi



Këshilli Drejtues i UP-së
Prof. Dr. Ismet Salihu - Kryesues